

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 07 / DHJETOR 2019

2018

editorial

Rron Gjinovci

RRONI E KA SHKRU NJI EDITORIAL SHUMË T'MEÇEM POR FATKEQËSISHT ËSHTË VANDALIZUAR NGA NJIGRUMBULL I KOMENTUESVE



ORCA

organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Templlarët:
Adea Kondirolli
Liridona Ademaj
Indrit Ferati
Zogë Hasani
Valon Dervishaj
Vesel Veseli
Dibran Hoxha
Sara Sylejmani
Lyra Hoxha
Skord Retkoceri
Gramos Buçinca
Rron Gjinovci



Dizajni:
Visar Arifaj - Kabineti

Kontakti:
www.orca-ks.org
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë



Instagram:
Tempulli_i_dijes

KITU

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky publikim është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

Perla nga arsimi i lartë

GJETJE THESARI DHE COPËZA ILUMINIMI NGA BËRTHAMA E DITURISË

NGA TDS



Indrit Ferati

Perla nga CV-ja:

Hulumtuesit e ORCA-s pas hulumtimeve të CV-ve të punonjësve akademik, kanë qenë shumë afër orgazmave profesionale pasi ishin dëshmitarë të CV-ve të mega-profesorëve. Ne e kemi parë të arsyeshme që të provojmë t'iu "qefleisim" edhe juve, dashamirë.

AFTESISTE E KOMUNIKIMIT	Të folurit në mënyrë adekuate me një shumëllojshmëri të njerëzve, ndërsa duke mbajtur kontakt me sy, demondtrimi i një vokabulari të pasur dhe përshtatja e gjuhës me audiencën, dëgjimi në mënyrë efektive, teshkruarit në mënyrë të qartë dhe koncize dhe të punuarit mire në grupe, përdorimi i mediumit të duhur, dhënja dhe marrja e feedbackut, etj.

Kjo CV ka të bëj me një profesor empirist, i cili i kushton rëndësi shumë shqisave. Disa studentë kishin dyshuar se profesori në fjalë po luan me hile, pasi mendonin se kishte instaluar 'qicën e wallhackut', ku i shikonte studentët përmes mureve se mos po flisnin pas shpinës keq për të.

SHKATHTËSI TË TJERA	Prirje për art dhe sport

Ky profesor kur kishte pasur intervistën me komision për të hyrë në punë, kishte ardh me fanelën e Ballackut me numër 13 dhe një top nërsjetëll. Komisioni ishte mahnitur se sa shumë kishte njohuri për finta. Njëri nga pjestarët e komisionit nuk ishte pro që ai të ishte pjesë e Universitetit, pasi në intervistë e kishte koritë duke i'a futur topin midis këmbëve... por kjo nuk ishte e gjitha. Pasi kishte bërë matjet me top ulur, ai morri lëpirësen dhe e futi në gojë. Pas afërsisht 6 minutave dhe 40 sekondave ai nxorri lëpirësen të cilën e kishte shëndrruar në portretin e rektorit me gjuhën e tij.

• Mësimdhënie, Dizajnim i programeve dhe syllabuese, realizimi dhe vlerësimi i tyre me metoda më të avanciuara, punë shkencore dhe kërkokimore, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare

Dizajnim I syllabuseve për mësimdhënie dhe implemetim I tyre me metoda më të avancualara të mësimdhënies, angazhim intelektual dhe pedagogjik.

Ky shkrim jep përshtypjen e parë se është i llojit "m'falni se 1 fmi i vogel e ka shkru", por jo. Këtu kemi të bëjmë fjalë me një profesor i cili ka shënuar CV-në e tij në pikën kulminante të zhegut. Ne si redaksi apelojmë që profesorët të strehohen verës nga ora 11:00 - 16:00, në atë mënyrë që të rritet cilësia në arsim.

Publikimet tjera

Titulli	*Libri*	*Titulli*
1. D.Hoti, S.Kacapor, E. E.Growing: Mozaik – A multicultural and bilingual approach to preschool education, Manual for Educators and Parents,	"Save the children" / Gjuha: Anglisht	2008, p. 120 Prishtinë
2. D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – pristup decijem predskolkom multikulturnom i dvojezicnom obrazovanju, Prirucnik za vaspitace I roditelje,	"Save the children" / Gjuha: Serbe	2008, p. 120 Prishtinë
4. D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – pristup decijem predskolkom multikulturnom i dvojezicnom obrazovanju, Prirucnik za vaspitace I roditelje,	"Save the children" / Gjuha: Boshnjake	2008, p. 120 Prishtinë
3. D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – Okul çok kultulu ve iki dilde çocuk egitimine yaklasim, Egimen ve ebeveynlere Yonik el kitabi,	"Save the children" / Gjuha: Turke	2008, p. 120 Prishtinë

Tempulli i Dijes ka angazhuar një agjent që të përfshihet në grupin e mbyllur të profesorëve në viber "Kërrk integriteti akademik". Aty ka pasur tutoriala të ndryshëm, si p.sh "5 mënyrat më të lehta për t'u bërë profesor". Njëra nga to ishte kjo foto, ku një punim shkencor (n'fakt raport OJQ-sh) e përkthen në gjuhë të ndryshme dhe i bën katër. Autorin e këtyre gjetjeve kreative e ftojmë që të rekrutohet në SHIK si 'Mbikqyrës i Dallavergjive'.

Perla tjera:



Për studentët që kanë dilema, google është destinacioni i duhur. Nëse edhe aty e keni nafakën që nuk gjeni përgjigje adekuate, Tempulli i Dijes është i përbërë nga:
1. Urolog
2. IT
3. Këshilltarë për studime.
Mirë se vini!


Redaksia ka rënë pre e provokimeve të armiqëve tonë nga njëri prej ishujve të Skenderajit. Nëse ju mendoni se ne e kemi të lehtë...ne nuk e kemi. Agjenti jonë i cili ka rënë pre e këtij provokimi, ka qenë shumë afër pranimit të ofertës, pasi i ka mbetur vetëm një provim në lëndën e një profesori që ka inat ndaj tij pasi nuk ka pranuar që t'ia blejë librin e tij.

Në stadiumin "Magazica" u mbajt turniri akademik "Platoni shënon". Studentët pas humbjes ishin arsyetuar se i kishte kapluar "msyshi". Redaksia e TD kishte dëgjuar se kur kapiteni i perfaqësuese së Universitetit për termina kishte ligjëruar lëndën e tij zgjedhore "Aplikimi i politikës në futboll", UP nuk ka pasur buxhet që të blihen topa "katërsh" të terminëve. Kështu njëri nga studentët kishte marr iniciativën që t'a marr topin gjysëm-origjinal që ia kishte sjellë daja nga Bullgaria. Inati dhe xhelozia mes studentëve tjetër që ndjekin lëndën "Aplikimi i politikës në volejboll", ka shtyrë që subjektet në fjalë ta çfryejnë topin e termineve para turnirit. Profesori i lëndës nuk e kishte të vështirë të shënonte gola, pasi temën e diplomës e ka mbrojtur me top fallc. Shpresojmë që këta student kur të bëhen politikan, ta ndryshojnë projektligjin për buxhetin e topave në Universitet dhe Kosova të ketë një të ardhme që e meriton.

Borgjezia Akademike

Hulumtim i të ardhurave personale të stafit akademik menaxherial në universitetet publike të Kosovës për vitin 2018.

5 Pjesëtarët e stafit menaxherial me të ardhurat më të larta në muaj



Ahmet Shala
Dekan në FIM, Universiteti i Prishtinës

Ilir Doci
Prodekan në FIM, Universiteti i Prishtinës

Nexhat Qehaja
Prodekan në FIM, Universiteti i Prishtinës

Myrvete Badivuku Pantina
Prorektore në Universitetin e Prishtinës

Haxhi Gashi
Dekan në F. Juridik, Universiteti i Prishtinës

5 Rektorët me të ardhurat më të larta në universitetet publike



Fadil Millaku
Universiteti i Pejës

Marjan Dema
Universiteti i Prishtinës

Bajram Kosumi
Universiteti i Gjilanit

Ismet Temaj
Universiteti i Prizrenit

Alush Musaj
Universiteti i Mitrovicës

5 Proektorët me të ardhurat më të larta në universitetet publike



Myrvete Badivuku Pantina
Universiteti i Prishtinës

Rifat Morina
Univeresiteti i Mitrovicës

Ibish Mazreku
Universiteti i Prizrenit

Behxhet Gaxhiqi
Universiteti i Gjakovës

Kadri Kryeziu
Universiteti i Prizrenit

5 Dekanët me të ardhurat më të larta në universitetet publike



Ahmet Shala
FIM, Universiteti i Prishtinës

Haxhi Gashi
F. Juridik, Universiteti i Prishtinës

Halil Kukaj
F. Ekonomik, Universiteti i Prizrenit

Januz Dërvodeli
F. i Edukimit, Universiteti i Gjilanit

Idriz Berisha
F. i Mjekësisë, Universiteti i Gjakovës

5 Prodekanët me të ardhurat më të larta në universitetet publike



Ilir Doci
FIM, Universiteti i Prishtinës

Nexhat Qehaja
FIM, Universiteti i Prishtinës

Vehbi Ramaj
F. i Biznesit, Universiteti i Pejës

Shpetim Lajqi
FIM, Universiteti i Prishtinës


Aferdita Berisha Shaqiri
F. Ekonomik, Universiteti i Prishtinës

KRONIKA E ZEZË





Universiteti n'lloç



Më 8 tetor 2018, ORCA pati dorëzu para Këshillit të Etikës së UP-së, denoncimin për 8 profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të cilët janë avancuar me punime në revista mashtruese.

Profesorët kishin publikuar nga 7 deri në 19 punime secili brenda një periudhe 1 vjeçare e gjysmë. Kjo gjë është e pamundur, nëse për asgjë tjetër atëherë për faktin e thjeshtë se një profesor i inxhinierisë mekanike në Norvegji, arrin të publikojë 0.96 punime në vit, pra as një punim të plotë.

Këta 8 veta u avancuan përmes një grumbulli punimesh. Shumica e punimeve përmbajnë plagjiaturë, gabime në drejtshkrim dhe gramatikë në gjuhën angleze, gjë që e bën të pamundur që ato të botohen në revista cilësore. Megjithatë, revistat ku ishin botuar këto punime ishin të indeksuara në platformën SCOPUS. Më pas ORCA iu është drejtuar kësaj platforme duke ngritur dyshime për këto revista. Bazuar mbi këto dyshime, SCOPUS i kishte përjashtuar revistat nga platforma e saj.

Të gjitha këto prova, nuk i mjaftuan Këshillit të Etikës së UP-së për të marrë masa e as për ta adresuar rastin më tutje. Ata, pas një vitit shqyrtim të rastit, thjeshtë erdhën në përfundimin absurd, se nuk kanë as mandat e as mundësi profesionale për ta kryer këtë punë. Kjo përgjigje është e papranueshme.

Tash, përtej çdo dyshimi të bazuar: Ahmet Shala, Ramë Likaj, Azem Kyçyku, Mirlind Bruçi, Naser Lajqi, Nexhat Qehaja, Rexhep Selimaj dhe Xhevat Berisha, janë avancuar me punime të publikuara në revista mashtruese.

Kjo nuk është asgjë tjetër veçse legalizim i avancimeve jomeritore e i plagjiaturës, kjo është thirrje e Këshillit të Etikës dhe përmes tij, e Senatit që njerëzit të angazhohen në plagjiaturë e në mashtrime sepse askush nuk do t'i ndëshkojë. Kjo është gjuajtje në lloç e universitetit.

Ëndërrimtarët e Universitetit

Dekani i Fakultetit Ekonomik, But Dedaj dhe profesoresha e po te njëjtit fakultet, Sevdije Alshiqi së fundmi po shohin ëndrra të shpeshta me avancime akademike. Këta dy profesorë, i kemi nxjerrë nga gjumi i thellë plot me ëndrra, përmes një aksioni të demaskimit të një reviste mashtruese, përmes së cilës revistë, profesorët në fjalë ëndërronin të avancoheshin.

Ne kemi dërguar një punim pa asnjë vlerë shkencore, me autorësi të një personi imaginar, Andrra Qielli, nga universiteti imagjinar Triumph University në Tiranë dhe revista 'International Journal of Research in Business and Social Science' përveç që nuk hezitoi ta botonte punimin menjëherë, ajo gjithashtu manipuloi datat e dërgimit të punimit, duke pretenduar se punimi është dërguar më herët se data reale, e gjitha kjo për vlerën 110 €.

Ne shpresojmë që Senati i Universitetit të Prishtinës të marrë masa menjëherë, duke e futur këtë revistë në listën e revistave mashtruese, ngase të dy profesorët e përmendur kanë marrë rekomandim për avancim në gradat e tyre akademike.

Gjumë të ëmbël, në ëndërrimet tjera...



Kjo fotografi nuk është montazh. Biblioteka Kombëtare e Kosovës e nderon familjen Koreane Kim Jong. Në foto janë babai dhe gjyshi i Kim Jong Un diktatorit aktual të Koresë së Veriut.

Privatet lëshojnë diplomë të pavlefshme

NGA TD6

Disa institucione të arsimit të lartë në Kosovë kanë kryer shkelje të rënda ligjore duke mos dorëzuar regjistrat e të dhënave të studentëve të tyre në MAShT. Kjo do të thotë se këto institucione kanë regjistruar studentë përgjatë kohës që nuk kanë qenë të akreditуar ose kanë regjistruar studentë përtej numrit të lejuar, bazuar në vendimet e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Mijëra studentë të cilët kanë ndjekur studimet në këto institucione mund të jenë pre e këtij mashtrimi. Kësisoj, diplomat e marra nga këto institucione nuk kanë bazë për t'u njohur në Kosovë apo jashtë saj.

Presim që kjo çështje të zbardhet nga organet kompetente dhe shkelësit të vendosen para drejtësisë. Po ashtu, ne presim që studentët viktima të këtij mashtrimi t'i drejtohen organeve të hetuesisë apo gjyqësisë duke ushtruar padi dhe kallëzime penale për institucionet që i kanë mashtruar ata.

Kosova dhe Shqipëria përveç tjerash kane te përbashkët edhe paaftësinë për të bërë shkencë të mirëfilltë.

TD5

Një studim i bërë nga "Nature"1 (International journal of science) dëshmon se Kosova dhe Shqipëria qëndrojnë më së dobëti në rajon sa i përket publikimit të punimeve shkencore.

Referuar të gjeturave të kësaj reviste rezulton se Shqipëria ka më pak se një publikim shkencor për dhjetëmijë banor, Kosova qëndron pak më mirë, por, jo me ndonjë dallim signifikant, sepse krahasuar me rajonin Mali i Zi ka sa dyfishi i Kosovës, ose pak ma shumë se Shqipëria e Kosova bashkë, e mos të flasim për Islandën e cila me 300 mijë banorë, ka 10-fishin e Kosovës.

Kjo paraqet më së miri dështimin tonë për të bërë shkencë, natyrisht që kjo paraqet deformimin e sistemit të arsimit që na ka përcjellë me vite, korrupsioni, nepotizmi, jo profesionalizmi, mungesa e meritokracisë, drejtësisë e barazisë, padyshim që shkaktojnë gjendjen që jemi sot në fushën shkencore dhe jo vetëm.

1 https://www.nature.com/articles/d41586-019-01565-0



TEMPULLI I DIJES • DHJETOR 2019, NUMRI 07

Përvjetorët në fushën e arsimit

janar

h	m	m	e	p	s	d
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

shkurt

h	m	m	e	p	s	d
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	

28 2019 PËRJASHTIMI NGA EQAR

mars

h	m	m	e	p	s	d
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

prill

h	m	m	e	p	s	d
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

maj

h	m	m	e	p	s	d
			1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

qershor

h	m	m	e	p	s	d

korrik

h	m	m	e	p	s	d

gusht

h	m	m	e	p	s	d

shtator

h	m	m	e	p	s	d

27 2017 SHKARKIMI I KSHC

tetor

h	m	m	e	p	s	d

3 2019 PËRJASHTIMI NGA ENQA

nëntor

h	m	m	e	p	s	d

23 2018 AVANCOHEN SUPERMENET E FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE

19 2019 KËSHILLI I ETIKËS NË UP AMNISTON SUPERMENËT E FIM-IT

dhjetor

h	m	m	e	p	s	d

3 2019 REZULTATET E PISA

FIQIRIME

NGA TD6

NJË SY UNIVERSITETIT

Prej vitit 1980, deri 2018 Universiteti i Prishtinës i ka publiku veç 1735 punime shkencore që i plotësojnë kriteret aktuale. Vitin 2017 e ka pasë ma t'suksesshmin, me gjithsejt 220 punime shkencore. Fakulteti me ma s'shumti punime shkencore është Fakulteti i bujqësisë dhe veterinarisë, me mesatarisht 8 punime për kokë profesori.

Në anën tjetër, ka edhe asi që nuk e shohin si t'nevojshme korrektësinë edhe integritetin akademik. Jonë t'kënaqun edhe me publiku punime sa për sy e faqe nëpër revista mashtruese, me t'cilat mundohen me i arsyetu titujt akademik. Fatkeqësisht, veç në periudhën 2007-2018, 153 profesorë kanë publikuar 502 punime në revista mashtruese.

502
punime në revista mashtruese

1980
1990
2000
2007
2018

1735
punime të vlefshme

viti 2017 është viti me më së shumti publikime, gjithsejt 220 punime shkencore. Fakulteti me më së shumti punime shkencore në UP është Fakulteti i Veterinarisë dhe Bujqësisë.

Nga 465 profesorë me tituj akademikë, 208 nuk e kanë asnjë punim të vlefshëm sipas kritereve aktuale. Po, kjo osht përafërsisht çdo i dyti profesor pa asnjë punim të vlefshëm.

nga 465 profesorë

çdo i dyti
nuk e ka asnjë punim të vlefshëm sipas kritereve aktuale

Rrjedhimisht, 276 profesorë, apo 59%, nuk i justifikojnë titujt akademik që i mbajnë. E për me e ndreqë hala ma shumë, 105 prej tyne janë Profesorë t'Rregullt, titulli ma i naltë akademik, çka ju siguron atyne kontrata të përjetshme të punës.

16 profesorë i kanë vjedhë punimet shkencore

13 dekanë nuk e kanë pranuar se janë në dijeni për rastet

0 dorëheqje

9 janë avansuar edhe pas publikimit të lajmit për vjedhje

3 janë suspenduar por janë kthyer prap

Po, nganjëherë edhe me e shkru nji punim për revista mashtruese mundet me tu dokë punë e madhe. Shumë ma lehtë osht, përshembull, me ia vjedhë punimin dikujt tjetër. N'botën akademike vjedhjes së pjesshme apo t'tërësishme t'veprës së dikujt i thuhet plagjiaturë.

276
nuk i justifikojnë titujt akademik që i mbajnë

105
nga ta janë profesorë të rregullt me kontrata të përhershme

Edhe pse nuk ka ndonji hulumtim t'thuktë për numrin e saktë të plagjiaturave në UP, janë 16 raste të njohura t'cilat janë raportu n'media. Sado që plagjiatura është kategorikisht e ndaluar në bazë të Kodit të Etikës, Rregullores për Masa Disiplinore, Statutit të Universitetit e bile edhe Kodit Penal, shumica e profesorëve të përfshirë nuk e kanë pa t'nevojshme as me reagu ndaj akuzave.

Për dorëheqje, as që vjen n'shprehje.

Edhe 13 dekanët e fakulteteve të UP-së, kur janë pyet n'lidhje me këto raste, thjeshtë kanë thanë që nuk janë n'dijeni për ndonjë rast të plagjiaturës.

Prej 16 këtyre rasteve, vetëm 3 janë suspendu, mirëpo t'tretë janë kthy prap, përveç njërit që nuk ka qenë mësimdhënës i rregullt e i është ndërpre kontrata.

gjeni ngjashmëritë!

Këshilli i Etikës së Universitetit të Prishtinës mori vendimin për rastin e supermenëve të FIM-it, ku thotë se "nuk kanë kompetencë" dhe "nuk kanë mundësi profesionale" për të verifikuar plagjiaturën.

A mundeni ju lexues të vëreni ngjashmëritë në mes të këtyre pjesëve nga dy punime në revistat International Journal of Mechanical Engineering and Technology (IJMET) dhe International Scientific Journal Industry 4.0, të dyjat të publikuara në vitin 2017.

INTERNATIONAL SCIENTIFIC JOURNAL "INDUSTRY 4.0" WEB ISSN 2534-997X; PRINT ISSN 2543-8582

PRODUCTION SYSTEMS SAFETY, MODELLING, SIMULATION AND THE POSSIBILITY OF AUTOMATION OF A PRODUCTION WAREHOUSE AS A KEY COMPONENT IN CIM SYSTEMS

Prof.Asoc.Dr. Bruci M. [1], Prof.Asoc.Dr. Likaj R.*. [1],
Faculty of Mechanical Engineering – University of Prishtina "Hasan Prishtina", Kosovo [1]
rame.likaj@uni-pr.edu (*corresponding author),

Abstract: *this paper deals with the safety, modeling, simulation and the possibility of automation of a production warehouse as a key component on CIM systems. The manufacturing has been changed significantly by using information systems. Using electronic data processing in the production systems and beyond, automatic protocols are derived and flow both on confirmation of the order and in economic aspect of the raw material. Also, information systems are used in planning and controlling the production, including machines, equipments and entire production process, as well as a lot more opportunities have been provided for the operator. But, security of the production systems is one of the concerns which are elaborated in this paper. Production systems play an important role in industrial and economic development of a country. Recent years, there was a tremendous change in the technology of production systems. Such changes happened as a result of advances in the field of hardware and software technology, which are directly or indirectly related to modeling and simulation of production systems. In this paper, we will investigate the possibility of automation of a production warehouse as one of the key components of CIM technology. Simulations are new and very attractive area. Nowadays they have become indispensable engineering tools for solving engineering tasks, leaving behind the traditional analytical methods. They include design, analytical and optimisation tasks of complex production systems, computer architecture, biological and military systems etc. This is made possible, because of failure to gain good results by the analytical methods, which is the case also for simple systems too. In the group of traditional methods are distinguished: arrays method (querying theory), different heuristic mathematical methods etc.This paper also deals with modelling and simulation of flexible system for electrical machine assembling by ARENA software.*

Keywords: *PRODUCTION SYSTEM, SAFETY, CRYPTOGRAPHIC, SIMULATION, CIM, WAREHOUSING.*

MODELLING, SIMULATION AND THE AUTOMATION OF A PRODUCTION WAREHOUSE AS A KEY COMPONENT IN CIM SYSTEMS

Mirlind Bruqi, Rame Likaj*
Faculty of Mechanical Engineering,
University of Prishtina, 1000 Prishtina, Kosovo
* Corresponding author: rame.likaj@uni-pr.edu

ABSTRACT

This paper deals with the modeling, simulation and the possibility of automation of a production warehouse as a key component on CIM systems. The manufacturing has been changed significantly by using information systems. Using electronic data processing in the production systems and beyond, automatic protocols are derived and flow both on confirmation of the order and in economic aspect of the raw material. Also, information systems are used in planning and controlling the production, including machines, equipments and entire production process, as well as a lot more opportunities have been provided for the operator. Production systems play an important role in industrial and economic development of a country. Recent years, there was a tremendous change in the technology of production systems. Such changes happened as a result of advances in the field of hardware and software technology, which are directly or indirectly related to modeling and simulation of production systems. In this paper, we will investigate the possibility of automation of a production warehouse as one of the key components of CIM technology. Simulations are new and very attractive area. Nowadays they have become indispensable engineering tools for solving engineering tasks, leaving behind the traditional analytical methods. They include design, analytical and optimisation tasks of complex production systems, computer architecture, biological and military systems etc. This is made possible, because of failure to gain good results by the analytical methods, which is the case also for simple systems too. In the group of traditional methods are distinguished: arrays method (querying theory), different heuristic mathematical methods etc. This paper also deals with modelling and simulation of flexible system for electrical machine assembling by ARENA software.

Keywords: Production System, simulation, CIM, warehousing.

Nëse arritët të gjeni ngjashmëritë, URIME! Ju keni aftësi më të larta të leximit se profesorët e Këshillit të Etikës. Ju inkurajojmë të aplikoni në konkursin për këshillin e ri, pasi ky këshill të shkarkohet.

udhëtime	qiraja	ushqimi	totale
Fakulteti i Arteve	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Fakulteti i Arkitekturës
14.80	122	6.66	200
euro në javë	euro në muaj	euro në ditë	euro në muaj
4.55	58	2.81	109
Fakulteti Ekonomik	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Përfundime

Megjithëse shpenzimet e studentëve të UP-së gjatë studimeve numërohen relativisht të larta, studentët nuk shpehin shqetësime të shumta, madje ata janë të kënaqur që shërbejnë si shtyllë elementare për mirëqenien e profesorëve. Gjatë diskutimeve në fokus grupe, është potencuar se në ShBA mesatarisht një student shpenzon $1200 në vit (libra & materiale të tjera shpenzuese), andaj krahasuar me këtë vlerë monetare, studentët e UP-së rangohen në një pozitë jashtëzakonisht të lakmueshme. Për më tepër, kushtet e këqija në konvikte nuk paraqesin ndonjë problem serioz duke marrë parasysh faktin që studentët i kalojnë në këto hapësira vetëm disa orë gjumë në ditë.

Sa i përket cilësisë së ushqimit në menzë, studentët ankohen me të drejtë. Me raste ndodhë që pireja të ofrohet me jahni pa mijane, aspekky që paraqet probleme serioze tek studentët që kanë alergji në gluten. Si pasojë, studentët janë të detyruar të konsumojnë ushqime të tjera alternative në mënyrë vetanake, ku për tre shujta në ditë nuk shpenzojnë më shumë se 4.7 euro.

Sipas të dhënave të hulumtimit, kryesisht del se studentët që më së shumti shpenzojnë para në udhëtime janë studentët e Fakultetit të Arteve, (14.8 euro në javë). Ky fenomen në rrafshin popullor shprehet si; "edhe artist edhe fshatar se rrok". Kurse studentët e Fakultetit Ekonomik janë ata që më së paku shpenzojnë për udhëtime (4.55 euro në javë). Përpos që njihen si kursimtarë të mëdhenj, studentët e këtij fakulteti konsiderohen si qytetar tejet të integruar në kryeqytet.

Sa i përket qirasë, studentët e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore shpenzojnë më së shumti (122 euro në muaj) kurse ata të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike shpenzojnë më së paku (58.33 euro në muaj), "sa ma ngushtë, aq ma gjonë" citohen të kenë thënë studentët e FIM. Për më tepër, ndarja e hapësirave banuese me kolegë praktikohet edhe në vendet e civilizuara të perëndimit, andaj studentët e këtij fakulteti preferojnë të jenë një hap me kohën.

Kur bëhet fjalë për shpenzimet e ushqimit, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike janë ata që prijnë në Universitet duke shpenzuar 6.66 euro në ditë, ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku, vetëm 2.81 euro në ditë. Ushqehen kryesisht me tosta te "VIZIT" dhe energji të diellit, me qëllim që të promovojnë vlerat ekologjike. Çfarë do që vjen prej Zotit është e mirëseardhur, prandaj edhe rrezet e diellit gëzojnë respekt të veçantë tek kjo kategori e studentëve.

Sa i përket shpenzimeve totale mujore, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës shpenzojnë më së shumti (200.38 euro në muaj), këto shpenzime kryesisht alokohen për aktivitete rekreative si tenis, polo, dhe golf. Ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku (109.61 euro në muaj).

Për pak me i harru bursat, kto universitare që zakonisht dalin n'llogari studentëve gjatë pushimeve verore, e kto te Ministrisë së Arsimit që ndahen sipas parimit "ku t'qëllon" për do fakultet po, për do fakultet jo. Hajgare, se ministria ka "plan strategjik afatgjat" (tri rrena ni fjali).

shporta e studentit

NGA TDS



Adea Kondirolli, Dibran Hoxha, Sara Sylejmani

70,313 STUDENTË

55.4% TË PAPUNË

25 EURO PËR SEMESTËR
+
37.7 EURO MESATARISHT PËR LITERATURË

Hyrje

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 70,313 studentë janë pjesë e sistemit universitar publik, megjithëse vetëm 55.4% e të rinjëve janë të papunë.

"Sa rrinë badihava ma mirë shko në shkollë", thotë një fjalë e urtë popullore. Ose, "më mirë bujk e me fakultet sesa bujk analfabet". Pritshmëritë e larta shoqërore për shkollimin e gjeneratave të reja kanë ndikuar që Kosova të konsiderohet si vatër e elitës intelektuale.

Pavarësisht çmimit të ulët të pagesës së semestrit, familjet kosovare kanë vështirësi në shkollimin universitar të fëmijëve të tyre. Paga mesatare në Kosovë për vitin 2017 është 471 euro neto dhe rrjedhimisht familjet hasin në vështirësi për ti mbuluar poashtu edhe shpenzimet e vizave dhe pagesave të tjera për programe "Exchange" janë vendit. Prandaj, ORCA ka vendosur të hulumtojë sa shpenzon një student në Universitetin e Prishtinës, në mënyrë që të kuptojmë natyrën e shpenzimeve, dhe çka mund t'i ofrojnë institucionet këtyre studentëve.

Të Dhënat e Përgjithshme

Universiteti i Prishtinës ngarkon studentët të paguajnë 25 euro për semestër, kurse viti i parë është falas. Kjo dukuri nuk aplikohet edhe për shtetasit e huaj pasiqë me këtë rast Kosova rrezikohet nga imigrimi legal.

Studentët në UP mesatarisht shpenzojnë 37.7 euro për semestër në literaturë gjatë studimit. Shumë herë ata janë vetë autorë të skriptave dhe materialeve të tjera mësimore mirëpo zakonisht me shumë dashamirësi ata mbështesin financiarisht profesorët duke i blerë librat e tyre.

"Studentët Lazdranë" konsiderohen ata të cilët ushqehen në mënyrë vetanake duke shpenzuar mesatarisht nga 5 euro në ditë. Kjo kategori e UP-së ankohen se mensa e studentëve nuk ofron ushqime të shijshme dhe se ushqimi në Qendrën e Studentëve nuk ka variatet.

Shpenzimet totale mujore për studentët e Universitetit të Prishtinës variojnë nga 25 (ja'u qafshim hallin) deri në 400 euro, ku përgjigjja më e shpeshtë është 150 euro. Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, pasiqë tregu i punës në Kosovë nuk është i hapur për të rinjtë.

Shpenzimet totale mujore:

përgjigja më e shpeshtë

25 euro

150 euro

400 euro




NGA TD2

Kronika Rosé

ORCA lufton për integritet akademik. Mirëpo qëllimi jonë nuk është me mbajt të pastër akademinë e populli me u kontaminu me mashtrime e vjedhje. Ksisoj, vendosëm që me eduku popullin edhe për integritetin e estradës - "integritetin rozë", për estradën që populli e ndjek me aq dashuri dhe përkushtim.



Estrada e UP-së po ashtu ka probleme serioze me plagjiaturë dhe integritet akademik.



Tayna - probleme me integritet rozë

Edhe pse redaksia e Tempullit të Dijes jon fansa t'flaktë të reperes Tayna, ne si kritikues të plagjiaturës nuk mundemi me hesht. Pavarësisht talentit t'teprum t'Taynes, ajo në videon e "Shqipe" është raportu nga mediet se ka vjedhë pikë-për-pikë videon e Teyana Taylor. Shënim i redaksisë: Tayna, ti din, don dhe ia del. Woohoo!

Drake thyen integritetin rozë - vjedh Elinel?

Ka raste edhe kur pretendohet se reperat amerikanë vjedhin reperat shqiptarë. Elinel-i e ka akuzu Drake që ja ka vjedhë kangën "Bullet" t'2012, dhe e ka qitë "Can't take a joke" t'2018. S'di d.m.th. është për me u admiru durimi i Drake i cili ka pritë 6 vjet që Elinel me harru kangën e vet. Por Elinel është symprehtë dhe i pamposhtur.

Redaksia TD ka lyp koment prej Drake në instagram, por siç duket Drake nuk ka gjetur kohë të përgjigjet. (Elinel forever)

Sabri Hamiti nga estrada akademike dyshohet për plagjiaturë


Ish-deputeti, ish-profesori, dhe anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës (lol), Sabri Hamiti, osht akuzu në 2005 që në librin "Tematologjia" t'botum nga AShAK-u ka **"huazu"** prej dy librave - një serb e një francez. Libri i vjedhun përveç që ka fitu çmim nga Ministria e Kulturës e Shqipnisë, ai përdoret ende në dy landë në bachelor e master në Fakultetin e Filologjisë.

RAPORTUAR NGA: ADMOVERE.ORG

Hajredin Kuçi estradë e shumëllojshme, së fundi në UP profesor i rregullt, i ka ca të meta

Ish-zëvendëskryeministri, e ish-ministri, e ish-prorektori, tash-profesor (fjala o veç për nji njeri), Hajredin Kuçi, osht akuzu në 2006 që në librin "Independence of Kosova/o - Stabilizing or Destabilizing Factor in the Balkans?" ka **"huazu"** prej të madhërishmit Enver Hasanit (problem n'veti o ky).

RAPORTUAR NGA: ADMOVERE.ORG



NGA TD

afati i prillit

Diagram i skenareve më të mundshme gjatë përgatitjes për provimet e prillit



Numër post-festiv



Lloji i analizes	Rezultati		Vlera referente	Njesia
Kolesteroli total	55.8	H	< 6.5	mmol/L
Trigliceridet	53.3	H	0.4 - 1.8	mmol/L
LDL - Kolesterol	63.6	H	2.30 - 4.90	mmol/L
HDL - Kolesterol	61.70	H	> 1.42	mmol/L